

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Zavarovalnica Triglav d.d. me seli të regjistruar në Miklošičeva cesta 19, SI-1000 Lubjanë, Slloveni dhe ASEF Holdco SARL me seli të regjistruar në Rue Lou Hemmer 8, 1748 Senningerberg, Luksemburg, përmes avokatit Filip Zafirovski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 17.08.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Zavarovalnica Triglav d.d. me seli të regjistruar në Miklošičeva cesta 19, SI-1000 Lubjanë, Slloveni dhe ASEF Holdco SARL me seli të regjistruar në Rue Lou Hemmer 8, 1748 Senningerberg, Luksemburg, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Arsano Medical Group d.o.o. me seli të regjistruar në Ilica 1A, 10000 Zagreb, Kroaci përmes shitblerjes së pjesëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 19, paragrafi (1), pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të hyrave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 30.07.2026, ndërsa e plotësuar më datë 07.08.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) është dorëzuar njoftimi për përqendrim nga Zavarovalnica Triglav d.d. me seli të regjistruar në Miklošičeva cesta 19, SI-1000 Lubjanë, Slloveni dhe ASEF Holdco SARL me seli të regjistruar në Rue Lou Hemmer 8, 1748 Senningerberg, Luksemburg, me të cilin të njëjtat do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Arsano Medical Group d.o.o. me seli të regjistruar në Ilica 1A, 10000 Zagreb, Kroaci.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit që nga dita e pranimi të tij dhe, në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

Veprimtaritë kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Zavarovalnica Triglav d.d. është shoqëria amë e grupit Triglav, e cila përbëhet nga 12 kompani sigurimi në Slloveni dhe Evropën Juglindore. Veprimtaritë kryesore të grupit janë ofrimi i shërbimeve të sigurimit, sigurimi i jetës dhe jo-jetës (sigurimi nga aksidentet, sigurimi shëndetësor dhe lloje të tjera të sigurimit) dhe risigurimi.

Zavarovalnica Triglav d.d. ofron shërbime në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërive të saj të varura Triglav Osiguruvanje SHA, Bul. Brigada e 3-të Maqedonase nr. 36, 1000 Shkup; Triglav Osiguruvanje Zhivot SHA, Bul. Brigada e 3-të Maqedonase nr. 36, 1000 Shkup; Shoqëria pensionale Triglav SHA, Bulevardi 8 Shtatori nr. 18, katin 2, 1000 Shkup dhe Triglav, menaxhimi me patundshmëri SHPKPNJP Shkup, Dame Gruev 8/5, 1000 Shkup.

ASEF Holdco SARL është një kompani holding e themeluar në Luksemburg që shërben si instrument investimi i fondit të kapitalit privat Adriatic Structured Equity Fund ASEF SCSp ("PKP Fondi I"), i cili këshillohet nga Provectus Capital Partners d.o.o. ("PKP"). PKP është një firmë udhëheqëse e pavarur investimesh në Evropën Juglindore, e themeluar në vitin 2018. PKP këshillon dy fonde të kapitalit privat me seli në Luksemburg – fondin e parë PKP Fondi I nga viti 2020 dhe fondin e dytë PKP EIJL Fondi II SCSp ("PKP Fondi II") nga viti 2025, të cilët investojnë në pjesëmarrje shumicë të kompanive në mbarë rajonin. Të dy fondet e kapitalit privat të këshilluara nga PKP kanë mbledhur mbi 260 milionë euro nga investitorë institucionalë (BERZH, FIE, fondet pensionale, kompanitë e sigurimeve, bankat, etj.) dhe kanë investuar në 8 platforma në Kroaci, Slloveni dhe Rumani, dhe së bashku kanë rreth 1.900 të punësuar.

Grupi i PKP-së, duke përfshirë edhe shoqëritë portofol të kontrolluara prej saj, nuk kanë subjekte ose aktivitete të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Arsano Medical Group d.o.o. është një kompani holding e një grupi aktiv në fushën e shërbimeve private shëndetësore. Rrjeti i Arsano Medical Group përbëhet nga spitale speciale, poliklinika dhe institucione të tjera shëndetësore në Kroaci dhe ofron një spektër të gjerë të shërbimeve shëndetësore, duke përfshirë shërbime parandaluese, specialistike-konsultative, diagnostikuese, kirurgjikale, rehabilituese dhe shërbime të tjera shëndetësore.

Arsano Medical Group d.o.o. përbëhet nga këto shoqëri, të gjitha me seli në Kroaci: Arsano Medical d.o.o., Arsano Medical Group d.o.o., Neomedik d.o.o., Spitali Special Dr. Nemec, Ariteria d.o.o., Spitali Special Ariteria, Orto-Artro d.o.o., Arsano Adria d.o.o., ASEF Aviva d.o.o., Poliklinika Aviva, Poliklinika Uro Centar, Institucioni Prima Nova, J.D.D. Resono d.o.o., Poliklinika për radiologji dhe diagnostikim neurologjik 2000, Arsano Oftalmo d.o.o. dhe Poliklinika Ritc Nova.

Arsano Medical Group d.o.o. nuk ka shoqëri të varura, degë ose përfaqësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon asnjë qarkullim në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat*,

gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ